



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Interpretimi i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian

Hyrje

Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës dëshiron që të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Duke pasur këtë parasysh, Qeveria ka planifikuar disa aktivitete kyçe në mënyre që të ngushtoj hapësirën në mes të Kosovës dhe Europës në disa çështje/tema të rëndësishme.

Plani për 2012 ('Plani i Veprimit për Zbatimin e Partneritetit Evropian për Kosovë') është miratuar nga Qeveria në Dhjetor të vitit 2011. Ky plan përfshinë një orar të detajizuar me më shumë se 600 aktivitete për Kosovën duke përfshirë një mori çështjesh të ndërlidhura për përafrimin e legjislacionit në Kosovë me *Acquis Communautaire* nga Komisioni Evropian.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të fokusohemi në aktivitetet e veçanta që dalin nga Plani i Veprimit, i cili sipas gjyqimit tonë, ka synim të veçantë/kyç dhe ka në fokus edhe qeverisjen lokale. Të përfshira në këtë dokument janë aktivitetet e mëposhtme:

- Aktivitetet ku komunat kanë përgjegjësi kryesuese ose rol përkrahës në procese;
- Aktivitetet tjera në të cilat komunat nuk kanë rol kryesues ose përkrahës, por ku supozohet se është e arsyeshme që qeverisja lokale do të këtë ndonjë përgjegjësi gjatë aktivitetit.

Në mënyrë që të bëjmë PVPE-në më të lehtë për tu përdorur nga komunat, në kemi ndryshuar rrjedhën në të cilën aktivitetet janë të prezantuara duke i ndarë ato në pjesë të ndara në secilën drejtori veç e veç. Ne po ashtu kemi interpretuar fjalët në aktivitetet e listuara në PVPE në mënyrë që të behët me relevante për punën e përditshme të komunave. Sidoqoftë, numrat origjinal për veprimet e posaçme janë mbajtur siç ishin, në mënyrë që ti referohemi PVPE-së dhe veprimeve nëse është e nevojshme për më shumë detaje. Referencë i është dhënë edhe Procesit për Stabilitet dhe Asociimit, grupeve punuese, në mënyrë që të ketë bashkë-dyzim në mes të PVPE-së dhe DPSA-se në procesin e monitorimit.

Komunat do duhet të marrin parasysh kërkesat për PVPE-në, në planifikimin dhe ofrimin e aktiviteteve/ose shërbimeve. Zyrtaret për Integritet Evropian në komuna kanë një rol kyç në ndihmën që duhet të ofrohet Kryetareve dhe Drejtoreve duke vendosur dhe konsideruar se si duhet të bëhet kjo më së miri në komunat e tyre, dhe duke monitoruar këtë zhvillim.

Përfundimisht, do duhet të jete e qartë se aktivitetet e PVPE-se për Qeverinë nuk janë të përpiluara si një plan konkret dhe komplet për shoqërinë e tërë, për qeverinë lokale apo atë qendrore. Ka disa çështje shumë të rëndësishme të cilat nuk janë prekur nga PVPE-ja; menaxhimi i mbeturinave dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore, për shembull, nuk janë pjesë qenësore e këtij dokumenti .

Prandaj ne kemi përgatitur një pyetësor për secilin drejtori me nga dy - tri pyetje në mënyrë që të kemi më shumë informacione për implementimin e veprimeve të PVPE-së në nivelin lokal.

Shpresojmë se ky dokument do të jetë ndihmesë, dhe shpresojmë të marrim komente nga ju deri më 11.05.2012 në këtë adresë:

Drin.haragia@rks-gov.net dhe vjosashehu@rks-gov.net

1. Zyra e Kryetarit

a) A janë krijuar burimet adekuate për Njësitë për të Drejta të Njeriut për pjesëmarrje në MAPL-e për të përkrahur programin?

Përgjigja: Po, kemi krijuar staf të mjaftueshëm dhe adekuat për Njësinë për të Drejtat e Njeriut. I raportojmë rregullisht MAPL-së. Gjithashtu e njoftojmë rregullisht kryetarin e komunës për punë tonë dhe i raportojmë drejtorit për administratë komunale sipas UA 01/11.

b) A ka raportim të vazhdueshëm mbi zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel lokal ndaj Divizionit të MAPL-së për të Drejtat e Njeriut në formën e duhur?

Përgjigja: Po, raportohet vazhdimisht sipas dinamikës së aplikuar të MAPL-së. Raportimi bëhet sipas planit të veprimit të Njësisë që hartohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Planin të Veprimit Kombëtar me specifika të Komunës për avancimin e të drejtave të njeriut dhe respektimin e tyre.

c) A ka zbatim të tërësishëm të rekomandimeve të Zyrës së Kryeministrit për përfaqësim proporcional të bashkësive jo-shumicë në shërbimin civil dhe kompanitë në pronë shoqërore?

Përgjigja: Nga 216 shërbyes civil në administratën komunale, prej tyre 13 janë nga komunitetet jo-shumicë (11 serbë, 1 turk dhe 1 ashkali). Ndërkaq, në arsim nga 1 111 punëtorë, 2 janë minoritarë. Në shëndetësi kemi 1 pjesëtar të komunitetit jo shumicë nga gjithsej 202 punëtorë.

d) A është bërë miratimi i rregulloreve komunale për përdorimin e gjuhëve zyrtare duke siguruar që ato zbatohen plotësisht dhe që janë furnizuar me staf të mjaftueshëm?

Përgjigja: Rregullorja për përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunë është e miratuar dhe si e tillë është plotësisht e zbatuar. Kjo Rregullore mbikëqyret nga NJKDNJ, përkatësisht nga zyrtari

për të drejtat e komuniteteve dhe lidhur me këtë raportohet vazhdimisht për zbatueshmërinë e saj.

e) A ndihmojnë zyrtarët për kthim në përgatitjen e raporteve vlerësuese në zbatimin e Strategjisë/Planit të Re-integrimit të Personave të Riatdhesuar?

Përgjigja: Koordinatori për kthim, i cili është pjesë e ZKKK-së, përgatit raportet mbi zbatimin e planit për kthim dhe riintegrim në periudha tremujore, përfshirë këtu edhe raportet për persona të riatdhesuar.

2. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

a) A është zhvilluar dhe zbatuar strategjia për burime njerëzore, që përfshinë procedurat e rekrutimit, vlerësimit, analizimin e nevojës për trajnim, politikat kundër-korrupsion, barazi gjinore dhe kundër-diskriminim?

Përgjigja: Po, gjithsesi edhe në Komunën tonë, ekziston strategjia për zhvillimin e burimeve njerëzore e cila po zbatohet, njëkohësisht me procedurat e rekrutimit, vlerësimit, analizimit të nevojës për trajnim, politikave kundër-korrupsionit, barazisë gjinore dhe mos diskriminimit. E gjithë kjo, po bëhet duke zbatuar Ligjet dhe UA për fushat përkatëse.

b) A janë definuar përmes një Rregulloreje Komunale të drejtat dhe përgjegjësitë e zyrtareve komunale, duke përfshirë definicionet se çka përben konflikt interesi, duke u siguruar që punëtorët nënshkruajnë Kodin e Mirësjelljes si një kusht për punësim?

Përgjigja: Definimi përmes Rregullores për të drejtat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve komunal ende nuk ka përfunduar, mirëpo me definicionin se çka është konflikt interesi, zyrtarët komunal janë të njoftuar përmes LVQL-së, Statutit të Komunës dhe trajnimeve të ndryshme. Ndërkaq, sa i përket kodit të mirësjelljes, secili zyrtar apo punëtor me rastin e nënshkrimit të kontratës është i obliguar që ta nënshkruaj edhe deklaratën e kodit të mirësjelljes, të cilat ruhen në dosjet e punës nga Shefi i Personelit.

3. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit

a) A janë kompletuar në kohë auditimi i jashtme dhe ai i brendshëm, dhe të njëjtat janë publikuar së bashku me masat për zbatimin e rekomandimeve të tyre?

Përgjigja: Po. Janë të realizuara dhe të kompletuara.

b) A janë zhvilluar planet për menaxhim e pyjeve për të ngritur prodhimin, mbrojtjen nga prerja ilegale, të cilat nxitin zhvillimin e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve, siç është edhe pyllëzimi i zonave të papyllëzuara?

Përgjigja: Komuna e Vushtrrisë, bazë për menaxhimin e pyjeve e ka Planin e Menaxhimit të Pyjeve, i hartuar dhe i paraqitur nga Agjencia Kosovare e Pyjeve. Ky plan shërben si bazë për prerje, rrallim, pyllëzim, menaxhim dhe mbrojtje të pyjeve në Komunën e Vushtrrisë.

Njëkohësisht, ju bëjmë të ditur se Kryetari i komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka hartuar një plan të brendshëm, në të cilin parashihen ndërmarrje të hapave në përmirësimin e kushteve për rojet e pyllit dhe mbrojtjen e pyjeve nga prerja ilegale.

Në kohën e fundit kemi efekte pozitive në terren, në raport me mbrojtjen e pyjeve.

4. Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Ambient

a) A është miratuar strategjia dhe planit për Rregullimit e lagjeve joformale?

Përgjigja: Në qershor të vitit 2009 është aprovuar Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Planin Zhvillimor Urban (PZHU) dhe në kuadër të këtij plani janë dhënë konturat e përgjithshme për trajtimin e këtyre vendbanimeve e që më vonë me Aprovimin e Planeve Rregulluese do të detajohen edhe më shumë.

b) A është zhvilluar plani lokal për mbrojtjen e ambientin, duke përfshirë informata për tokën e ndotur dhe kualitetin e ajrit?

Përgjigja: Në prill të 2011 është aprovuar Rregullorja mbi Mbrojtjen e Mjedisit, ndërsajemi ne përgatitje te Planit Lokal te Veprimit ne Mjedis për te cilën jemi ne bisedime me REC(Qendra Rajonale e Mjedisit) për realizim te këtij projekti.

c) A janë marrur masa për të parandaluar dëmtimin e pyjeve/maleve dhe tokave në male si rezultat i gurëthyesve?

Përgjigja: Gurëthyesit momental nuk operojnë në hapësira të tokave të kulturës – mal.

5. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

a) A është përgatitur plani operacional për shëndetësinë primare dhe Sigurimin që ajo siguron dhe shërbimet shëndetësore, dhe në të cilat shërbime kanë qasje komunitetet jo-shumicë, me theks të veçante të drejtuar ndaj Romeve, Ashkalive dhe bashkësisë Egjiptiane?

Përgjigja: Shërbimet e Kujdesit Primar janë përgjegjësi e komunave. Këto shërbime ju ofrohen të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë pa dallim etnie, përkatësi fetare apo gjinie, dhe për këtë nuk kemi pranuar ndonjëherë vërejtje qoftë me shkrim apo me gojë.

b) A janë organizuar aktivitete për të ngritur vëmendjen/informimin se si të qasen asistencën sociale veçanërisht grupet e cenuara siç janë të kthyerit dhe komuniteti jo-shumicë?

Përgjigja: Varësisht nga nevojat, organizohen takime me karakter informim. Ndërkaq, kushdo që paraqitet në Qendër për Punë Sociale, informohet rreth kriterëve të përcaktuara me ligj për të gëzuar asistencë sociale, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë.

6. Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinise dhe Sportit

a) A është punuar me shkollat fillore dhe ato të mesme për të ngritur nivelin e përfundimit të shkollës, veçanërisht nga nxënëset femra dhe ato nga zonat rurale duke siguruar transport adekuat për në shkollë?

Përgjigja: Drejtoria e Arsimit ka punuar dhe po punon vazhdimisht në ngritjen e nivelit të përfundimit të shkollës, e posaçërisht për nxënëset femra. Po ashtu në komunën tonë, ka transport në të gjitha zonat rurale.

b) A është ngritur numri i inspektorëve komunal të arsimit, duke siguruar që ata po ashtu janë të trajnuar?

Përgjigja: Nuk është ngritur numri i inspektorëve komunal të arsimit.

7. Drejtoria e Emergjencës, Mbrojtjes dhe Shërbimeve Publike

a) A janë të gjitha rrugët lokale janë të pajisura me shenja në mënyrë që të promovohet siguria në rrugë si për shoferët e automjeteve gjithashtu edhe për këmbësorët?

Përgjigja: Drejtoria për Shërbime Publike, ka bërë një varg investimesh në ndërtimin dhe sinjalizimin e rrugëve lokale të Komunës së Vushtrrisë, mirëpo në mungesë të buxhetit nuk ka arritur që në tërësi të bëjë sinjalizimin. Aktualisht të gjitha rrugët e qytetit të Vushtrrisë janë të sinjalizuara me sinjalizim vertikal, ndërsa rreth 35% me sinjalizim horizontal. Po ashtu, rrugët lokale në fshatra pranë shkollave dhe vend ndaljeve për autobus janë të sinjalizuara, ndërsa rrugët tjera lokale nuk janë të sinjalizuara.

b) A është zhvilluar plani lokal për menaxhimin e mbeturinave?

Përgjigja: Drejtoria për Shërbime Publike posedon Plan për menaxhimin e mbeturinave.